

Dragiša (Dane) Stojčević

(5.12.1978, serb nga Karavukova, komuna Oxhaci, pjesëtar i UJ-së)

Dragiša jetonte në Karavukovë, së bashku me prindërit, motrën, gjyshin dhe gjyshen. Pasi e ka mbaruar shkollën e mesme për axhustator, ka shkuar në kryerjen e shërbimit të rregullt ushtarak në Prishtinë/Prishtina në muajin dhjetor të vitit 1997. Ishte tankist në Batalionin e Parë të Brigadës së Pesëmbëdhjetë të Blinduar. Në datën 23.10.1998, familjarëve të tij i ishte bërë të ditur zyrtarisht se Dragiša kishte rënë te *Kroi i Mbretit/Careva česma [Korroticë e Epërme/Gornja Koretica]*. Familjarët kanë mësuar më vonë nga miku i Dragishës nga ushtria, Miljani, se ata që të dy më **22.10.1998** ishin larguar nga njësi i vet dhe se ushtarët e UÇK-së i kishin zënë rob. Pak pas, dikush ka hapur zjarr mbi forcat e UÇK-së, gjë që i provokoi ata ta rikthenin zjarrin kundër Dragišës dhe Miljanit. Dragišen e kanë vranë në vend, ndërkaq Miljani vetëm u plagos. Trupi i Dragišës iu dorëzua familjarëve më 24.10.1998. Një ditë më vonë, u bë varrimi i tij në varrezat e Karavukoves.

Burimet: deklarata D.A, FDH-25377; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 68; USCG KGDH, *Regjistri..*, FDH-8817; SMIP, *Teroristički..*, III, 980; KKKMKRFJ, *Personat..*, FDH-10832; ICTY, IT-05-87 (Milutinović dhe të tjerë), EX.3D01010, FDH-31352.

Shemsi (Rashit) Elshani

(3.12.1987, shqiptar nga Krajkova/Krajkovo, komuna e Gllgocit/Glogovac, nxënës)

Shemsiu, 11 vjeç, jetonte me prindërit Rashitin dhe Hasimen, si dhe vëllain Dardanin në **Krajkovë/Krajkovo**. Në të njëjtën shtëpi jetonte edhe familja e axhës Bahtiarit. Në mëngjesin e datës **24.10.1998**, Shemsiu shkoi me babanë dhe kushëririn Ademin në pyll përmbi shtëpinë e tij për të ngarkuar dru për zjarr. Por, forcat serbe papritmas shtënë ndaj tyre nga drejtimi i bjeshkës *Potork*. E qëlluan Shemsiun dhe e vranë në vend. Familjarët e kanë varrosur Shemsiun në varrezat e Krajkovës/Krajkovo më 26.10.1998.

Burimet: deklarata A.B, FDH-16546; deklarata A.E, FDH-32016; *Pact brings no peace to Kosovo villagers*, Los Angeles Times, 26.10.1998, FDH-32007; *Serb forces kill children in Kosovo*, The Independent, 1998, FDH-32008; Novinski članak, CNN, 1998, FDH-32009; *Gunman were on funeral of young girl*, The Michigan Daily, 27.10.1998, FDH-32010; *Warless Kosovo still searching for peace*, FDH-32011.

Fatmir (Rexhep) Isufi

(29.1.1970, shqiptar nga Çikatova e Re/Novo Çikatovo, komuna e Gllgocit/Glogovac, tregtar, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Pas vrasjes së anëtarëve të familjes Jashari në Prekazin e Poshtëm/Donje Prekaze [të shikohet regjistrimi], Fatmiri aderoi në UÇK. Gjatë muajit prill të vitit 1998, ka qenë në Shqipëri për ta kryer trajnimin ushtarak. Ka rënë më **10.11.1998**, rreth orës 16:00, në betejë me pjesëtarët e forcave serbe që ndodhi në afërsi të stacionit hekurudhor në **Bajicë/Banjica**. E kanë qëlluar me plumb në kokë. Një ditë më vonë, pjesëtarët të UÇK-së e kanë varrosur Fatmirin në varrezat e Bajicës/Banjica.

Burimet: deklarata S.I, FDH-31849; J. Martinsen, *Regjistri..*, FDH-26092.

Abedin (Salih) Bujupi

(25.12.1971, shqiptar nga Arllati/Orlate, komuna e Gllgocit/Glogovac, hidraulik, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Për shkak të aktivitetit të tij politik kundër regjimit serb, Abedinit iu desh të braktiste Kosovën dhe të shkonte në Gjermani në vitin 1991. U kthye pas tre vjetësh, por shumë shpejt sërish u detyrua të shkonte në Gjermani. Në muajin maj të vitit 1998, Abedini u kthye në Arllat/Orlat dhe iu bashkëngjit UÇK-së. Vepronte pranë shtabit të UÇK-së në Llapushnik/Lapušnik. Në datën **10.11.1998**, Abedini u nis me veturën e vet të tipit *Ford Skorpion* nga Likoci/Likovac për në Negroc/Negrovce. Në udhëkryqin e **Negrocit/Negrovce**, i cili e ndan rrugën për Arllat/Orlate, atë e kanë vërejtur forcat serbe, të cilat ishin të stacionuara përkaj udhëkryqit. Hapën zjarr menjëherë ndaj veturës dhe e qëlluan Abedinin. Ka mbetur i vdekur në vend.